



BULETINI I PARË SOCIAL DHE MJEDISOR
Tirana International Airport





Dr. Constantin von Alvensleben
Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv
Foto: TIA/Jutta Benzenberg

TË NDERUAR LEXUES,

Nëse kthejmë kokën pas në vitin 2005, arritja më e madhe është padyshim marrja përsipër e menaxhimit të Tirana International Airport nga Tirana International Airport SHPK (TIA)*, më 23 prill 2005. Kjo arritje shkoi më tej me vendosjen e gurit të themelit të terminalit të ri më 6 maj 2005.

Kompania e re aeroportuale arriti të përballojë me sukses sfidat e fillimit si dhe ato që pasuan, falë një bashkëpunimi të shkëlqyer të stafit të saj dhe palëve të tjera të përfshira në këtë projekt, si aksionerët TIA-s, qeverisë shqiptare, pronarëve, kompanive ajrore, policisë si dhe kontraktorëve të tjerë që ofrojnë shërbimet e tyre dhe operojnë në Aeroport.

Numri i pasagjerëve dhe i lëvizjeve ajrore po rritet me shpejtësi dhe Aeroporti po i dëshmon qartë këto ritme. Aeroporti është qendra më e madhe e transportit në Shqipëri. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2006, rreth 691,504 pasagjerë udhëtuan nëpërmjet Aeroportit. Duke e

krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2005, ka patur një rritje prej 13 përqind në numrin e pasagjerëve. Ndërsa trafiku i lëvizjeve ajrore (ATM) nga muaji janar në shtator 2006, arriti 6,038 kundrejt 5,863 ATM që është shënuar për të njëjtën periudhë të vitit 2005.

Programi i zgjerimit të Aeroportit gjithashtu ka përparuar dukshëm. Aeroporti është në procesin e modernizimit rrënjësor, fakt që do të ndikojë në rritjen e nivelit të shërbimeve si dhe në përmirësimin e nivelit të menaxhimit. Ceremonia e përirimit të terminalit të ri është planifikuar në pranverën e vitit 2007.

Buletini i Parë Social dhe Mjedisor do të informojë për aktivitetet e TIA-s në lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit mjedisor të përcaktuar që nga data e fillimit të koncesionit dhe do të ilustrojë progresin e TIA-s në kuptimin e rëndësisë së mjedisit dhe mbrojtjes së tij.

Juaji sinqerisht,

*më parë e njohur si Tirana Airport Partners (TAP)

Misioni i Tirana International Airport SHPK është t'i ofrojë Shqipërisë një infrastrukturë prestigjioze aviacioni ndërkombëtar, shërbim të sigurtë të klasit të parë për pasagjerët dhe kompanitë ajrore. Për ata që do të fluturojnë për në këtë vend, përshtypja e parë dhe e fundit do të jetë Aeroporti i kryeqytetit të tij i menaxhuar mirë.

PËRSE DUHET NJË BULETIN SOCIAL DHE MJEDISOR?

Tirana International Airport SHPK (TIA), si kompania menaxhuese e Tirana International Airport, është angazhuar në garantimin e sigurisë, përmirësimin e nivelit të shërbimeve ndaj klientit dhe në lidhje me gjithçka që ofron një Aeroport. TIA ka premtuar gjithashtu ta shndërrojë Aeroportin në një nga strukturat më moderne të infrastrukturës në vend.

Deri në vitin 2007, Aeroporti do të normalizohet gradualisht dhe do të zgjerohet në përputhje me kërkesat në rritje. Aktualisht po punohet për ndërtimin e një terminali të ri. Infrastruktura e terminalit të vjetër po përmirësohet dhe po ndërtohet një parkim i ri makinash dhe një terminal mallrash. Një fazë e mëtejshme zgjerimi do të aplikohet në vitet që do të vijnë për t'iu përgjigjur zhvillimit dhe rritjes së trafikut të pasagjerëve.

Duke marrë parasysh punën e madhe që po kryhet në zonën e Aeroportit gjatë fazave të zgjerimit, TIA është angazhuar të respektojë mjedisin dhe jetën e komunitetit lokal e të minimizojë impaktin që mund të prekë popullsinë e zonës për shkak të operimeve dhe zgjerimit të Aeroportit. TIA është e vetëdijshme për rolin e rëndësishëm në sigurimin e standardeve të larta të shëndetit mjedisor në

rrethinat e Aeroportit. Për këtë qëllim, çdo vit, Tirana International Airport do të publikojë një Buletin Social dhe Mjedisor, me qëllim që jo vetëm të përmbushë detyrimet sipas legjislacionit shqiptar, por edhe të dokumentojë aktivitetet në këtë fushë dhe të tregojë angazhimin e kompanisë ndaj objektivave që ka për kujdesin ndaj mjedisit.

Me këtë botim, kompania e aeroportit synon të inkurajojë partnerët e saj të biznesit që të marrin pjesë aktive dhe t'i bashkohen kësaj kompanie në iniciativat për një mjedis më të mirë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në këtë mënyrë ky bashkëpunim, do të jetë faktor për një nivel të lartë të përfitimeve social-ekonomike dhe mjedisore.

Tirana International Airport SHPK është kompania koncesionare e përbërë nga HOCHTIEF AirPort, një nga drejtuesit e nivelit botëror si menaxher dhe investitor privat në fushën e aeroporteve, DEG-Deutsche Investitions- und Entwicklungsgesellschaft, anëtar i Grupit Bankar KfW Banking Group, i specializuar në financimin e korporatave dhe investimeve për infrastrukturën, si dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërrmarjeve (FSHAN), një kompani investuese themeluar në vitin 1995 nga Kongresi Amerikan për të mbështetur kalimin e Shqipërisë drejt një tregu të lirë.



Dy përfaqësuesit e TIA-s, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Dr. Constantin von Alvensleben (djathtas) dhe Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve Z. Rolf Castro-Vasquez, duke nënshkruar më 4 prill 2006, Politikën e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë. Foto: TIA/Jutta Benzenberg

POLITIKA E MJEDISIT, SHËNDETIT DHE SIGURISË

Tirana International Airport SHPK vlerëson rëndësinë e mirëmbajtjes dhe kujdesit për një mjedis të pastër në Shqipëri. Në mars dhe prill të vitit 2006 TIA zhvilloi dhe përshtati një Politikë të Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë (Politika EHS). Me Politikë të Mjedisit, Shëndetit, dhe Sigurisë kuptohet një cikël i vazhdueshëm ku të gjitha masat e marra janë subjekt vlerësimi. Kjo përjasje siguron një përmirësim të vazhdueshëm dhe një nivel më të lartë operimesh që mbrojnë mjedisin dhe që ofrojnë siguri dhe shëndet në punë.

Politika EHS përshkruan në mënyrë të përgjithshme qëllimet e TIA-s dhe shërben si orientim për punonjësit e saj, klientët, aksionerët dhe pronarët e zonës përreth.

Përfaqësuesit e TIA-s, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve kanë nënshkruar më 4 prill 2006, Politikën e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë. Për më tepër, TIA hartoi një udhëzues për Menaxhimin e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë si një hap të parë drejt zbatimit të sistemit të menaxhimit të mjedisit.

CILESIA

CILESIA E UJIT DHE TRAJTIMI I UJERAVE TE ZEZA

TIA operon me dy impiante për thithjen e ujërave nëntokësorë. Në vjeshtë 2005 TIA bëri analiza të cilësisë së ujit të dalë nga këto impiante, në zonën e koncesionit. Këto analiza u bënë me synim që të kemi një panoramë të qartë të cilësisë së ujit në zonën e uljes dhe ngritjes së avionëve për të parë mundësinë e ngritjes së një stacioni uji të pijshëm për Aeroportin. Testet dhe analizat u kryen në Shqipëri me përjashtim të disa parametrevë të veçantë që u analizuan në Gjermani në tetor 2005 dhe shkurt 2006. Rezultatet tregojnë cilësinë e ujit nëntokësor dhe përcaktojnë se nuk ka asnjë tregues për ndonjë ndotje të mundshme. Asnjë nga parametrat e analizuar nuk i kalon limitet e përcaktuara sipas standardit shqiptar për ujin e pijshëm (STAH 3904:1997).

Sistemi i ri i drenazhimit do të ndërtohet si një sistem i pavarur për drenazhimin dhe pastrimin e ujërave të zeza. Impianti i pastrimit dhe i kullimit të ujit – në fazën fillestare – do të jetë në gjendje të përballojë nevojat për ujë për 1.5 milionë pasagjerë në vit. Impianti respekton standardet europiane. Ndërtimi i sistemit të drenazhimit dhe pastrimit të ujit është në proces e sipër.

E AJRIT CILESIA E UJIT

CILËSIA E AJRIT

Dy burime (emetues) për ndotjen e ajrit u analizuan në Tirana International Airport:


- Burimi i parë i ndotjes është zona e ndërtimit të terminalit të ri dhe ndërtesave rreth tij.
- Ndotjet e aeroplanëve që prodhohen nga avioni kur ngrihet dhe ulet si dhe nga mjetet e tjera që ofrojnë shërbimet në tokë.

Në gusht 2005, TIA bëri analiza të cilësisë së ajrit në Aeroport dhe në zonën e ndërtimit të terminalit të ri. Testimet dhe analizat u kryen në bashkëpunim me institutin shqiptar përkatës dhe përfunduan në tetor 2005.


Rezultatet tregojnë se cilësia e ajrit në Aeroport është e mirë dhe asnjë parametër i analizuar (ozoni, dioksid sulfuri, oksid nitrogjeni, dioksid nitrogjeni, okside të nitrogjenit (NOx)) nuk i kalon limitet e përcaktuara në vendimin shqiptar Nr. 804/2003 dhe as limitet e lejueshme europiane.

Monitorimi prej 24-orësh i profileve të ndotësve të ozonit dhe dioksidit të sulfurit (si në grafikun më sipër ku matjet janë bërë në terminalin ekzistues) tregohet në dy diagramët.

20.-21.10.2005 Tirana International Airport



20.-21.10.2005 Tirana International Airport



Në grafikët më sipër rezultatet tregojnë se cilësia e ajrit në Aeroport është e mirë dhe se asnjë nga parametrat e analizuar nuk i kalon limitet.

Buletini i Parë Social dhe Mjedisor



Kjo fushë pranë aeroportit ishte përdorur në mënyrë të paligjshme për hedhjen e mbeturinave. Kur mori përsipër menaxhimin e operimeve, Tirana International Airport inicioi pastrimin e saj. Foto: TIA/A. Ising, J. Benzenberg

MENAXHIMI I PLEHRAVE

Në vazhden e strategjisë së menaxhimit të TIA-s pas datës së fillimit të koncesionit, zona e fushës së Aeroportit e mbushur me plehra, u pastrua me një aksion intensiv. Mbledhja e plehrave, pastrimi i përditshëm dhe hedhja e tyre në vendin e caktuar po bëhet nga një kompani e specializuar dhe e kontraktuar për këtë qëllim. Kapanët e rinj të plehrave tashmë nuk lejojnë që të mblidhen kafshë dhe shpendë, si zogj, qen e mace duke ndihmuar kështu në eliminimin e ndotjes që ato shkaktonin.

SIGURIA OPERACIONALE

Me këtë Politikë të Mjedisit, Shëndetësisë dhe Sigurisë, Tirana International Airport është angazhuar për një zhvillim dhe operim të Aeroportit me përgjegjësi të lartë ndaj kujdesit të mjedisit. Gjatë ndërtimit dhe operimit të shërbimeve të Aeroportit, mbrojtja e mjedisit dhe ofrimi i shërbimeve me cilësi e standarde të larta, mbeten synimet kryesore të TIA-s. Tregues i këtyre angazhimeve të TIA-s është edhe një plan emergjence i përgatitur dhe i aprovuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil në dhjetor 2005. TIA bleu gjithashtu edhe një makinë të re "Follow Me" që përdoret për të drejtuar lëvizjet në pistë e cila plotëson standardet europiane përsa i

përket kujdesit ndaj mjedisit. Uniformat e reja të stafit janë prodhuar në Gjermani dhe përmbushin standardet europiane të cilësisë dhe sigurisë. Shëndeti dhe siguria në zonën e ndërtimit është nën kontrollin e menaxherit të mjedisit për ndërtimin. Ai raporton tek organi i zbatimit të projektit të caktuar nga qeveria shqiptare. TIA ka ndërtuar një mjedis të ri social për punonjësit, sidomos për ata të sigurisë si dhe ata që ofrojnë shërbimet në pistë. Ky ndërtim përfshin banjo, duze, dhe dhoma zhveshje për stafin. Dhomat janë të pajisura edhe me pajisje të ndihmës së shpejtë. TIA gjithashtu përfundoi me sukses trajnimin mbi ndihmën e shpejtë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Mjediset e reja janë ndërtuar në jug të terminalit ekzistues.

TRAJNIMI PËR MJEDISIN, SHËNDETIN DHE SIGURINË

Në prill 2006 u bë në Tiranë një trajnim për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë për disa anëtarë kryesorë të stafit të TIA-s. Trajnimi u organizua me mbështetjen e kompanisë HOCHTIEF AirPort. Stafi u trajnua nga një menaxher i mjedisit të Hamburg Airport. TIA është e vetëdijshme që i gjithë personeli puna e të cilëve mund të ketë impakt në mjedis duhet të trajnohet në përputhje me Politikën e Mjedisit, Shëndetësisë dhe Sigurisë dhe me vetë objektivat e TIA-s.



Rrënojat e kështjellës së Prezës, që ndodhet në afërsi të aeroportit. Tirana International Airport SHPK do të sponsorizojë zhvillimin e planit të turizmit për komunitetin e kësaj zone. Foto: TIA/Jutta Benzenberg

PROGRAMI SPONSORIZUES I TIA-s

TIA, si kompania menaxhuese e Aeroportit dëshiron të përmbushë detyrimet e saj sociale duke sponsorizuar projekte të rëndësishme dhe duke dhënë kështu një kontribut të shquar në zhvillimin e turizmit në Shqipëri. TIA ka identifikuar si një projekt të përshtatshëm për sponsorizim planin e zhvillimit të komunitetit të Prezës.

TIA vlerëson turizmin si të një rëndësie të veçantë për të ardhmen e Shqipërisë. Klima mesdhetare me verën e nxehtë dhe të thatë favorizon zhvillimin e kësaj industrie. Plazhet e shumtë, por edhe malet dhe parqet natyrore përbëjnë një potencial të mirë për turizmin në vend, por ky potencial ka nevojë të shfrytëzohet.

Natyrisht, nevojiten masa strategjike për ta bërë turizmin një bosht thelbësor të zhvillimit ekonomik, politik dhe shoqëror në vend.

Në fillim të tetorit 2006, TIA ka lëshuar një thirrje për projekte me temën: Plani i zhvillimit të turizmit për komunitetin e Prezës. Tirana International Airport synon të ofrojë këshillimin e nevojshëm me qëllim hartimin e një plani afatmesëm për zhvillimin e Prezës. Më pas TIA do të zgjedhë kompaninë këshilluese dhe do të drejtojë procesin

në fazën e aplikimit. Ky projekt pritet të plotësohet në vitin 2007 dhe më pas do t'u bëhet i njohur publikut dhe medias nëpërmjet një fushate informimi.

Plani i zhvillimit do t'i tregojë komunitetit mënyra dhe mundësi për të nxitur potencialin turistik, por në të njëjtën kohë do të jetë dhe një mjet i mirë për të bërë të njohur angazhimet e TIA-s kundrejt komunitetit, partnerëve dhe klientëve.



Kontakt:

Znj. Alma Bako

Drejtores e Departamentit të Cilësisë,

Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë

E-mail: abako@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK

Tirana International Airport Nënë Tereza

Rinas, Tiranë

Shqipëri

Tel: 00355 4 379 063/064

Faks: 00355 4 379 065

info@tirana-airport.com

www.tirana-airport.com

Statusi: Tetor 2006

Botuar: Janar 2007